



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 08.04.2025

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.2) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 (paragrafi 63.1.3) të Rregullores për Prokurim Publik /Nr.001/2022 e plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren Nr. 002/2024, të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 02.04.2025, të parashtruar nga Operatori Ekonomik "One-Grup" SH.P.K., lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me pajisje bujqësore-Bletari", Nr. i prokurimit- Nr. i prokurimit- 632-25-1797-1-2-1, Nr. i brendshëm-632-25-24-121, nxjerr:

V E N D I M

1. Aprovohet si pjesërisht e bazuar kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit Ekonomik "One-Grup" SH.P.K., e dt.02.04.2025, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me pajisje bujqësore-Bletari", Nr. i prokurimit- Nr. i prokurimit- 632-25-1797-1-2-1, Nr. i brendshëm-632-25-24-121, kundër DOSJES SË TENDERIT DHE NJOFTIMIT PËR KONTRATË, të publikuar me datë 14.03.2025, të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së.
2. Korigjohet DOSJA E TENDERIT DHE NJOFTIMI PËR KONTRATË, i publikuar me datë: 14.03.2025;
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të bëjë korigjimin e Dosjes së tenderit dhe Njoftimit për kontratë.
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe publikohet në platformën elektronike të KRPP-së.

Arsyetim

Operatori Ekonomik "One-Grup" SH.P.K., me dt.02.04.2025, ka parashtruar kërkesës për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me pajisje bujqësore-Bletari", Nr. i prokurimit- Nr. i prokurimit- 632-25-1797-1-2-1, Nr. i brendshëm-632-25-24-121.

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 08.04.2025, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Te pika 5. Kërkesa:

"OE duhet të dëshmojë se ka se paku një Veteriner i diplomuar dhe një inxhinier i diplomuar i elektroteknikës"

largohet Inxhinier i diplomuar i elektroteknikës por mbetet veterinari sepse është i nevojshëm pasi përfituesve të bletarise ju duhen edhe keshillat profesionale sa i përket bletëve dhe përdorimit të mekanizmit.

Te pika 9. Kërkesa :

"OE duhet të dëshmojë se ka se paku një Menaxher të diplomuar (në fushën e Menaxhimit të Biznesit)"

largohet nga Kushtet për pjesëmarrje.

Pretendimet e juaja janë pjesërisht të bazuara dhe në këtë pikë Autoriteti kontraktues do të bëjë korigjimin e dosjes së tenderit.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar në ato që u thanë më lart ka vendosur si në dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së . Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit të këtij vendimi.

Kopje: Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit të Komunës;
Te gjitha palëve të interesuara;


Menaxher i Zyrës së Prokurimit